




Kosova dhuron 2022

RAPORTI MBI GJENDJEN E FILANTROPISË

SI I MBËSHTET KOSOVA INDIVIDËT DHE FAMILJET?


Nga viti 2018 deri në vitin 2022, qytetarët dhe kompanitë në Kosovë kanë dhuruar më shumë se 4 milionë euro për të mbështetur individët dhe familjet përmes 3,246 rasteve të dhënies. Shuma më e lartë e donacioneve të dhëna për këtë grup është arritur në vitin 2020, mbi 2.6 milionë euro në total. Në vitin 2022, individët dhe familjet janë mbështetur me më shumë se 232 mijë euro përmes 363 rasteve të dhënies.

Trendet në dhënien për individët dhe familjet



Si i mbështet diaspora individët dhe familjet?

Në vitin 2020, mbështetja e diasporës arriti kulmin e saj, duke kanalizuar më shumë se 1.4 milionë euro përmes 126 rasteve të dhënies. Në vitin 2022, diaspora ka mbështetur individë dhe familje me më shumë se 75.9 mijë euro përmes 90 rasteve të dhënies.




Kush ishin donatorët në vitin 2022?

Vitin e kaluar, individët kontribuan më shumë dhe dhuruan 55.7% të shumës totale, duke marrë pjesë në 37.3% të rasteve të dhënies.



Cilat shkaqe morën mbështetjen më të madhe në dhënien për individët dhe familjet?

Pjesa më e madhe prej 232,240 euro të mbledhura për të mirën e individëve dhe familjeve në Kosovë gjatë vitit 2022, është dhuruar me qëllim të zbutjes së varfërisë. Mbështetja për grupet e marginalizuara gjithashtu mori një pjesë të konsiderueshme të shumës.



Donacionet për individë dhe familje ishin kryesisht donacione të njëhershme – 95.3% e shumës së dhuruar dhe 81.8% e rasteve të dhënies ofruan mbështetje afatshkurtër.



Dëshironi të dini më shumë? Të gjitha informacionet rreth donacioneve për individët dhe familjet në Kosovë në vitin 2022 mund t'i gjeni në [këtë link](#).

Burimi: kosovadhuron.org



Kjo infografikë është bërë e mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Catalyst Balkans dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesë vjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).